

VENDIM
Nr. 1, datë 6.2.2018

Bazuar në ligjin 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, të ndryshuar, dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror””, KDZH, e ngritur me urdhër nr. 389, datë 20.11.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave, u mbledh më datë 6.2.2018, dhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori i Shërbimit të Dokumentacionit, sipas kërkesës së studiuesit Marin Mema,

VENDOSI:

1. Deklasifikimin plotësisht të informacioneve të klasifikuara “sekret shtetëror”, si më poshtë:
 - Fondi 505 (Ministria e Financave), viti 1973, D. 38 “Tepër sekret”.
 - Informacione mbi disa probleme të punës për nxjerrjen e arit dhe argjendit në uzinën e bakrit Rubik, dërguar Koço Theodhosit, si dhe relacion mbi gjendjen e monedhës në thesar, dërguar Xhafer Spahiut.
 - Fondi 496 (Ministria Industri Miniera), viti 1979, D. 796, “Tepër sekret”.
 - Projektplanin për prodhimin e metaleve të çmuara për vitin 1979, ardhur nga uzina e bakrit Rubik, si dhe projektplanin i Ministrisë dërguar Komisionit të Planit të Shtetit.
 - Fondi 496 (Ministria Industri Miniera), viti 1979, D. 682, “Tepër sekret”.
 - Bilanci i arit për raportin e metalurgjisë për 3-mujorin e parë dhe të dytë të vitit 1979, ardhur nga uzina e bakrit Rubik.
 - Fondi 496 (Ministria Industri Miniera), viti 1980, D. 569, “Tepër sekret”.
 - Evidencë e ardhur nga uzina e bakrit Rubik për shitjen e arit dhe argjendit për vitet 1976, 1977, 1978, 1979.
 - Fondi 496 (Ministria Industri Miniera), viti 1980, D. 768, “Tepër sekret”.
 - Projektplanin i prodhimit të arit dhe argjendit për vitin 1980 dhe relacioni përkatës dërguar Komisionit të Planit të Shtetit.
 - Fondi 490 (Këshilli i Ministrave), viti 1985, D. 861, “Sekret”.
 - Njoftime të Ministrisë së Financave për grumbullimin e argjendit që përfitohet nga larja e filmave dhe fotografisë, si dhe për shkrirjen e arit dhe argjendit të dërguar në uzinën e bakrit Rubik.
 - Dosjet deklasifikohen sepse kanë humbur vlerën dhe qëllimin për të cilën janë klasifikuar, si dhe informacione mbi metalet e rralla që gjenden te Fondi 14 (Komiteti Qendror), janë deklasifikuar vite më parë.
2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së për zbatimin e këtij vendimi.
3. Një kopje e bibliografisë t’i dërgohet DSIK-ut, si dhe për botim në Fletoren Zyrtare.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMISIONIT TË DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT Drejtori i
Përgjithshëm
Ardit Bido